



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE)  
Uprava za Opšte Administrativne Poslove

06 Nr./Br. 413/01-18805  
Data 15.05.2018  
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

## THIRRJE PËR APLIKIM – 2019

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunën e Gjakovës, në kuadër të Programit “Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme” shpall konkurs për GRANTE të BIZNESEVE të angazhuara në fushë të prodhimit, përpunimit dhe artizanateve tradicionale. Qëllimi i granteve komunale është që të synohet zgjerimi dhe forcimi i kapacitetave të tyre, të nxitet rritja e punësimit, të sigurohet qëndrueshmëria dhe të jenë aktive në mënyrë që bizneset e tyre të kontribojnë në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Gjakovës!

Vlera e financimit të një Granti do të jetë nga **2,000 deri në 5,000 €uro**

Përzgjedhja e përfituesit bëhet në mënyre konkurruese! Shuma e grantit përcaktohet nga plotësimi i kritereve të shënuara më poshtë:

### I. KRITERET E GRANTIT:

1. Të jenë biznese që operojnë në komunën e Gjakovës, ku edhe duhet të bëhet investimi!
2. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në Komunën e Gjakovës.
3. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku **NJË** punonjës përvèç pronarit.
4. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku **NJË** punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi.
5. Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve. *Këtë e dëshmojnë përmes formularit të ATK “Gjendja e Përgjithshme e Qarkullimit”*
6. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi.
7. Bizneset duhet të dëshmojnë se kanë kujdes të duhur në ruajtje të ambientit nga ndotja e mundshme prej operimit të biznesit të tyre. Për këtë bizneset duhet të posedojnë Aktvendimin Sanitar nga Komuna dhe Licencën nga Ministria përkatëse e linjës ( nëse është e aplikueshme).
8. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën 35 vjeçare dhe nga minoritetet.

9. Plani i investimit duhet të specifikohet mirë, kështu që në momentin e aplikimit biznesi duhet të sjellë Profaturën për paisjen/paisjet, sipas Planit të Investimit.
10. Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më **20%** të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes, dhe nga vlera e grantit të fituar.
11. Bizneset duhet të dëshmojnë se i kanë të paguara obligimet ndaj ATK.
12. Bizneset duhet të kenë të përfunduara obligimet e taksës në firmë, tatimit në pronë, dhe obligimet ndaj KRM “Çabrati”,.

## **II. ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI:**

1. Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës.

## **III.SHUMA E PËRFITUAR E GRANTIT:**

Vlera e Grantit varet prej kapacitetit të qarkullimit të cilën bizneset e dëshmojnë përmes formularit të ATK “Gjendja e Përgjithshme e Qarkullimit”, prej numrit të punësuarve, dokumentacionit të rregullt që kërcohët, veprimtarisë dhe vizitës në terren.

Vlerësimi i dokumentacionit dhe i biznesit të aplikuesëve për grante, bëhet nga Komisioni Vlerësues i përbërë nga pesë anëtarë, të paraparë sipas Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës.

## **IV.FORMA E PAGESËS SË GRANTIT:**

Granatet do të jepen në formën e parave të gatshme, pasi që biznesi sjell dëshminë respektivisht faturën/faturat për blerjet (investimet) që i ka bërë, e të cilat duhet të janë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me Profaturë.

**SQARIM:** Nëse zgjidheni përfitues i grantit komunal, atëherë nënshkruhet Kontrata me Komunën/DZHE dhe ju pastaj duhet të sillni Faturën me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve, dhe atëherë Komuna e bënë reimbursimin e mjeteve financiare në vlerë të grantit, pas dëshmisë së transferit bankar nga xhirologaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (shitësi).

## **V. KRITERET JOKUALIFIKUESE:**

Biznesi nuk kualifikohet nëse:

1. Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet
2. Ishkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar
3. Keni qenë përfitues të Grantit nga DZHE në të kaluarën.
4. Ka orientime apo qëllime politike
5. Kërkon grante për të blerë tokën për ndërtim të lokacionit
6. Merret vetëm me tregtimin e produkteve
7. OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë
8. Keni bërë ndryshim në biznes pas datës së shpalljes publike për Aplikim.
9. Nëse shuma në aplikimin e biznesit është nën ose mbi shumën e vlerës së financimit.

## **VI. SI TË APLIKOHET?**

### **1. MËNYRA E PARË :**

#### **APLIKACIONI SHKARKOHET NGA WEBFAQJA E KOMUNËS NË INTERNET:**

Klikoni në webfaqen e Komunës në internet: <http://kk.rks-gov.net/gjakove/> ku do të shkarkoni aplikacionin dhe pasi ta keni plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet, të aplikoni **në formën fizike** në zyrën e Arkivës të Komunës së Gjakovës .

### **2. MËNYRA E DYTË:**

#### **APLIKACIONI MERRET DIREKT NË ZYREN PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT NË KOMUNË TË GJAKOVËS:**

Ju në zyrën për regjistrimin e biznesit në Komunën e Gjakovës do të merrni formën e Aplikacionit të shkarkuar dhe do ta plotësoni (forma elektronike ose me dorëshkrim), të cilën së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet më poshtë, e dorëzoni në zyrën e Arkivit të Komunës .

**KUJDES:** Para se t’i dorëzoni Aplikacionin dhe dokumentet që kërkohen në këtë thirrje, kontaktoni njërin nga zyrtarët në zyrën për regjistrimin e biznesit, për të verifikuar se i keni të kompletuara dokumentet për APLIKIM! Nga zyrtarët e kësaj zyre, do të merrni edhe instrukzionet dhe sqarimet shtesë, lidhur me dokumentet që duhet ti bashkëngjitni Aplikacionit.

### **KU DORËZOHEN APLIKACIONET:**

Aplikacionin së bashku me dokumentacionin e kërkuar, e dorëzoni në **ARKIVËN** e Komunës së Gjakovës, ku protokollohet dokumentacioni dhe ju do të merrni numrin e protokollit, që dëshmon se JU KENI APLIKUAR.

## **VII. AFATI I APLIKIMIT:**

Afati i aplikimit është prej datës **15 Maj deri 04 Qershor 2019 (ora 15:30)**

**Kujdes:** Afati për aplikim është 21 ditë kalendarike, andaj aplikoni me kohë brenda këtij afati.

## **VIII. FAZA E PARË E KUALIFIKIMIT:**

Nëse kaloni fazën e parë të selektimit, në bazë të dokumentacionit të prezantuar, atëherë do të kontaktoheni nga zyrtarët komunal të DZHE për hapat e mëtutjeshëm!

Sqarim: Zyra për regjistrimin e bizneseve e Komunës së Gjakovës është në objektin e Ish Bankosit, në hyrje të objektit në krahun e majtë.

Suksese!

## **DOKUMENTACIONI:**

### **CILAT DOKUMENTE DUHET TI DORËZONI?**

Për të aplikuar me dokumentacion komplet, nevojiten këto dokumente:

1. *APLIKACIONI*
2. CERTIFIKATA E BIZNESIT (kopje), me Informatat shtesë me kode të veprimtarive.
3. VENDIMI SANITAR nga Drejtoria e Inspeksionit
4. LICENCA nga Ministria e përkatëse e Linjës, nëse aplikohet
5. *VËRTETIMIN nga ATK*, që keni të punësuar së paku **NJË** punonjës në biznesin tuaj.
6. *VËRTETIMIN nga ATK* ( Administrata Tatimore e Kosovës) për shlyerjen e obligimeve.
7. Gjendja e Përgjithshme nga ATK për vitin 2018 dhe tre mujori pare i vittit 2019.
8. *PROFATURËN e RREGULLT* me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme përfurnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me çmimin kushtues. (**PRO FATURA sjellet në fazën e APLIKIMIT**)
9. *VËRTETIMIN* që nuk keni obligime (borgje) në taksen në firmë, tatimit në pronë dhe kompanisë së mbeturinave Çabratit.
10. *XHIROLLOGARIA* e biznesit (konfirmim nga banka)

**VEREJTE:** *FATURËN* e rregullt dhe transferin bankar nga xhirollogaria e biznesit tuaj në xhirollogarinë e biznesit të shitësit të pajisjeve duhet ta sillni **nëse e fitoni grantin.**